



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



Data: 31 Dhjetor 2018

Të nderuar,

Në vitin 2019, të siguarit e Fondit për sigurim shëndetësor do të kenë mundësinë të shërbehen me shërbime shëndetësore që do të përfshihen në buxhetin e përgjithshëm prej 30 miliard e 792 milion denarë ose mbri 500 milion euro.

Rrija e buxhetin në vitin 2019 është mbi 2 miliard e 200 milion denarë më i larë në krahasim me vitin 2018. Kjo rritje është si rezultat i priorititetit që ka Qeveria e Republikës së Maqedonis për sektorin e shëndetësisë, për këtë arsye janë rritur transferet nga buxheti qëndror. Janë rritur edhe të ardhurat nga kontributet si rezultat i rritjes së aktiviteteve ekonomike në Maqedoni.

Gjithashtu, Fondi për sigurim shëndetësor ka ndarrë buxhet rekort për Institucionet shëndetësore publike në vlerë prej 16,5 miliard denarë. Ky buxhet është për 1,5 miliard denarë më i lartë krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2018. Gjatë shpërndarjes së buxhetit nëpër institucione, Fondi ka listuar prioritet si në vazhdim:

- ✓ Ndarrje e mjeteve për rritjen e pagave të personelit mjekësor në shëndetin publik
- ✓ Punësime të reja në vitin 2019 nëpër institucionet shëndetësore me personel mjekësor
- ✓ Mjete për të paguar borxhet e disa institucioneve shëndetësore publike
- ✓ Mjete të konsiderueshme që ndryshe njihen si buxhete kushtëzuese për qëllime të përcaktuara paraprake nga ana e institucioneve shëndetësore publike.

Në vazhdim do të veçojmë disa buxhete kushtëzuese që do tju ndahen institucioneve shëndetësore publike:



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



- Buxhet kushtëzues për tu furnizuar me barna të reja do të ketë Klinika universitare për onkologji, hematologji, neurologji dhe reumatologji
- Buxhet kushtëzues me vlerë më të lartë se 1 milion euro kemi siguruar për Klinikën për hematologji dhe imunologji për 14 transplante të palcës së kockës nga donator i palidhur. Transplant të tillë të suksesshëm kemi patur për herë të parë këtë vit nga Klinika për hematologji. Rastet e tilla deri më tani Fondi i ka përcjellë për mjekim jashta shtetit ku çdo transplant në veçanti më së paku ka kushtuar 110 mijë euro, ndërsa për rastet më të ndërlikuara është tejkaluar vlera prej 200 mijë euro.
- 10 milion denarë kemi ndarë për Klinikën për gastro-entero-hepatologji për terapi biologjike për pacientët me sëmundje të kronit.
- Mbri 30 milion denarë do të ndahen për Klinikën e fëmijëve për tu furnizuar me faktor 8 për fëmijët që janë të prekur me sëmundjen e hemofilisë.
- 20 milion denarë i kemi siguruar Klinikës për kardiologji për tu furnizuar dhe instaluar 1.000 stenta shtesë
- Buxhet shtesë prej 25 milion denarë kemi ndarë për PET-Qendrën për ta rritur vëllimin e punës

Prej Institucioneve shëndetësore private që kanë marrëveshje me Fondin, do ti veçojmë:

- 3 miliard e 180 milion denarë kemi ndajtur për mjekët amë. Këtu marrin pjesë edhe 30 milion denarët që kemi rritur kapitationin e gjinekologëve
- 3 miliard e 50 milion denarë do të ndahen për rrjetin e barnatoreve për shpërndarjen e barnave që i mbulon Fondi. Rritja është për 150 milion denarë më e lartë krahasuar vitin 2018.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



- Mbi 530 milion denarë do të ndahen për paisjet ortopedike gjegjësisht 70 milion denarë më shumë krahasuar buxhetin fillerastar të vitit 2018.

Vlen të theksojmë se Fondi ndau 2 milion euro për ta filluar projektin 'Sistem informacioni shëndetësor i integruar', me anë të së cilit do të digjitalizohen proceset financiare dhe mjekësore në sistemin e tërësishëm shëndetësor. Mund të thuhet se kjo është një ndër projektet informatike më të ndërlikuara të shtetit, realizimi i së cilit do të zgjatë më së paku 3-4 vite dhe do të kushtojë më shumë se 2 milion euro. Qëllimi i këtij projekti është që qytetarët e Maqedonisë të kenë dosie personale elektronike dhe ti ngjajë sistemit shëndetësor bashkohor.